

VENDIM
Nr. 656, datë 8.10.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT “FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET SANITARE NË ORIKUM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Furnizimi me ujë dhe shërbimet sanitare në Orikum”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “pemishte” dhe “ullishte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 47 415 (dyzet e shtatë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 47 415 (dyzet e shtatë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, programi “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, zëri “Kosto lokale”, parashikuar për Njësinë e Menaxhimit të Projekteve (PMU).

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 113 000 (njëqind e trembëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme të Ujësjetllës - Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT “FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET
SANITARE” NË ORIKUM

Nr.	Emër, atësia, mbiemri	Zona/kad	Nr.pasurie	Sip.në m ²	Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
1	Bashkëpronësi Avdi Nika	3140	141/2	77	Pemishte	327	25179	Konfirmim
2	Petref Lameborshi	3140	67/2	68	Tokë Ullishte	327	22236	Konfirmim
	Totali i sipërfaqes për shpronësim			145		654	47415	